

Në pajtim me nenin 42 të Ligjit për arsim të mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/108), Ligjit për arsim profesional dhe trajnim (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013; 137/2013, 41/2014, 55/2016 dhe 64/2018 dhe („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 275/2019), Ligjin për akademinë e sportit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 115/2014, 129/2015, 146/2015, 30/2016 dhe 142/2016 dhe 64/2018), Ligjin për Gjimnazin Matematikë – Informatikë dhe Konkursit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme publike për vitin shkollor 2020/2021 në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga data 27 mars 2020, Komisioni i shkollës për regjistrimin e nxënësve të rregullt në vitin e parë në Sh.M.Q.Sh “Saraj”- Shkup, shpall:

KONKURS INTERN

**-për regjistrim të nxënësve të rregullt në vitin e parë në
Sh.M.Q.Sh “Saraj”-Shkup për vitin shkollor 2020/2021-**

I . NUMRI I NXËNËSVE

Në Sh.M.Q.Sh “Saraj”-Shkup për vitin shkollor 2020/2021 regjistrimin e nxënësve në vitin e parë regjistrohen 204 nxënës në 6 paralele me mësim në gjuhën shqipe sipas planeve dhe programeve mësimore për:

1. Drejtimi Gjimnaz - 136 nxënës, 4 paralele, minimum 60 pikë

Nxënësit që nga viti i parë do të kenë mundësinë për regjistrim sipas plan programit mësimor për drejtimin gjimnazor:

- drejtimi matematiko natyrorë (kombinimi A)
- drejtimi matematiko natyrorë (kombinimi B)
- drejtimi humanitaro shoqëror (kombinimi A)
- drejtimi humanitaro shoqëror (kombinimi B)
- drejtimi gjuhësor-artistik (kombinimi A)
- drejtimi gjuhësor-artistik (kombinimi B)

2. Drejtimi ekonomi - juridik dhe tregëti - 68 nxënës , 2 paralele

- **teknik i ekonomisë** shq. 34 nx. 1 par. pr. 4v. minimum 60 pikë
- **administratë biznesi** shq. 34 nx. 1 par. pr. 4v. minimum 60 pikë

II. KUSHTET PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE

Kushtet për regjistrim të nxënësve janë:

- të ketë mbaruar arsimin fillor;
- të mos jenë më të vjetër se 17 vjeç
- të jenë përcaktuar për një nga planet dhe programet nga llojet e mëposhtme arsimore
 - a) gjimnaz
 - b) arsim profesional dhe trajnim
- t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Konkurs.

Nxënësit e përkatësisë etnik rome mund të regjistrohen në shkolla të caktuara të mesme publike nëse kanë deri në 10% më pak pikë nga numri i pikëve të parapara me Konkursin për planet dhe programet mësimore të përshtatshme, edhe nëse i plotësojnë kriteret plotësuese për testim të njohurive dhe aftësive për shkollën e caktuar.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

Gjatë aplikimit, nxënësit duhet të sjellin dokumentet e mëposhtme:

- fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjen për regjistrim nxënësi mund ta marrë në shkollën ku nxënësi dëshiron të regjistrohet dhe e njëjta është falas);
- dëftesat origjinale nga klasa e VI deri në të IX;
- diplomë (nëse disponon, për vendin e I-rë, II-të dhe III-të) të fituara në gara shtetërore dhe ndërkombëtare nga gjuha amtare, gjuhë e huaj, shkenca natyrore, matematikë, kimi , fizikë, biologji dhe gjeografi dhe lëndë mësimore të cilat janë të rëndësishme për drejtimin dhe lëmin zgjedhore.
- certifikatë nga libri amë i të lindurve (pa marrë parasysh datën e lëshimit)

IV. AFATET E KONKURSEVE

Paraqitja dhe regjistrimi i nxënësve realizohet në një afat regjistruar me tre paraqitje në muajin qershor.

-Paraqitja dhe regjistrimi i parë në afatin e regjistrimit të qershorit realizohet më **16 dhe 17 qershor 2020 prej orës 08,00 deri 15,00**, ndërsa rezultatet nga regjistrimi dhe vendet e lira do të publikohen më **18 qershor 2020**.

Testimi kualifikues do të organizohet në shkollë në **22 qershor 2020** në lëndët të cilat janë të rëndësishme për profesionin, respektivisht degës zgjedhore:

- **Ekonomi - juridik dhe tregëti** do të testohen në lëndët matematikë dhe histori,
- **Gjimnaz** do të testohen nga lëndët varësisht nga drejtimi i zgjedhur kështu që:

drejtimi matematiko natyrorë (kombinimi A) matematikë dhe fizikë
drejtimi matematiko natyrorë (kombinimi B) matematikë dhe biologji
drejtimi humanitaro shoqëror (kombinimi A) matematikë dhe histori
drejtimi humanitaro shoqëror (kombinimi B) matematikë dhe histori
drejtimi gjuhësor - artistik (kombinimi A) matematikë dhe histori
drejtimi gjuhësor - artistik (kombinimi B) matematikë dhe histori.

Ndërsa rezultatet do të publikohen në **22 qershor 2020**. Kontrollimi i njohurive të nxënësve të bashkësive do të realizohet në gjuhën në të cilën nxënësi e ka ndjekur arsimin fillor.

Pas publikimit të rang listave, nxënësit të cilët nuk janë regjistruar në shkollë janë të obliguar që në afat prej 48 orëve ta tërheqin dokumentacionin e dorëzuar, gjithashtu edhe shkollat janë të obliguar që në afat prej 48 orëve tua kthejnë dokumentacionin.

-Paraqitja dhe regjistrimi i dytë i nxënësve do të realizohet në **24 dhe 25 qershor 2020 prej orës 08,00 deri 15,00**, ndërsa rezultatet nga regjistrimi dhe vendet e lira do të publikohen në **26 qershor 2020**.

-Paraqitja dhe regjistrimi i tretë i nxënësve do të realizohet në **29 korrik 2020 prej orës 08,00 deri 15,00**, ndërsa rezultatet nga regjistrimi dhe vendet e lira do të publikohen në **30 korrik 2020**.

Nxënësit të cilët dërgohen në riprovim, provim të vitit, provim për avancim më të shpejtë, mund të regjistrohen në shkolla ku do të mbeten vende të lira pas afatit të qershorit, më 24 gusht 2020 të cilët dorëzojnë dëshmi të dokumentacionit.

V. KRITERET PËR PËRZGJEDHJE

Kriteret për përzgjedhjen e nxënësve janë:

- sukcesi mesatar prej klasës së VI-IX;

- Për suksesin mesatar nga klasa e VI deri në klasën e IX, nxënësi mund të fitojnë më së shumti 50 pikë (suksesi i përgjithshëm nga klasa e gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë mbledhet, ndahet në katër dhe numri i njëjtë shumëzohet me koeficientin 10)

- sukcesi mesatar i nxënësit i arritur nga katër lëndë (gjuhë amtare, gjuhë të huaj, dhe dy lëndë të cilat janë të rëndësishme për drejtimin);

- Për suksesin mesatar të arritur nga katër lëndë mësimore të propozuara (dy lëndë mësimore të detyrueshme për të gjitha llojet e arsimit dhe dy lëndë mësimore të cilat janë të rëndësishme për drejtimin), nxënësi mund të fitojë më së shumti 20 pikë (5 pikë për çdo lëndë)

- diploma (për vendin e I-rë, II-të dhe III-të), të fituar në gara ndërkombëtare si dhe shtetërore (të organizuara nga shoqatat e akredituara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës) , nga gjuha amtare, gjuhë e huaj, shkenca natyrore, matematikë, kimi fizikë, biologji dhe gjeografi dhe lëndë mësimore të cilat janë të rëndësishme për drejtimin dhe lëmin zgjedhore;

- Për vende të fituara në gara ndërkombëtare dhe gara shtetërore nxënësi mund të fitojë më së shumti 5 pikë. (Për vend të fituar në gara ndërkombëtare 5 pikë, për vend të fituar në gara shtetërore : 3 pikë për vendin e I-rë , 2 pikë për vendin e I I-të dhe 1 pikë për vendin e I I I-të). Nxënësit i vlerësohet vetëm një diplomë që i sjell më shumë pikë

- vlera mesatare nga pikët e fituara për sjelljen;

- Për vlerën mesatare të pikëve për sjelljen prej klasës së VI deri në klasën IX nxënësi mund të fitojë më së shumti 5 pikë. (Sjellja shembullore vlerësohet me 5 pikë, sjellja e mirë vlerësohet me 3 pikë dhe sjellje e pakënaqshme vlerësohet m 0 pikë. Vlera mesatare është shuma nga pikët për sjelljen nga klasa e gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë të pjesëtuar me 4)

Nxënësi sipas të gjitha kriterëve të caktuara me këtë Konkurs mund të fitojë më së shumti 80 pikë.

Në shkollat ku paraqiten nxënës me numër më të madh, nga numri i planifikuar me pikë të barabarta, do të organizohet test kualifikues nga lëndët të cilat janë të rëndësishme për drejtimin.

Për nxënësit të cilët kanë mbaruar klasën e nëntë në Republikën e Maqedonisë së Veriut , ndërsa një, dy apo tre klasë (VI,VII apo VIII) kanë përfunduar jashtë vendit, për ato klasë do të merret sukse si nga klasa e nëntë dhe do të vlejnjë të gjitha kriteret e njëjta të lartë përmendura gjatë përzgjedhjes së nxënësve.

**Shkup,
Prill, 2020**

**Kryetar i Komisionit të shkollës
Drejtor
Bedri Gjureci**
